



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

**RAPORTI VJETOR 2020 PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË REALIZUAR
NGA
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

1. Përmbledhja ekzekutive *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme ka planifikuar 36 akte që do të miratoheshin gjatë vitit 2020. Vetëm njëra prej tyre ishte kualifikuar për konsultim publik. Ky akt kishte si objektiv miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022 të përgatitur nga ministrinë përgjegjëse për secilin kapitull të negociatave të pranimit në BE. Takimi publik i konsultimit u mbajt, megjithatë komentet e mbledhura nuk u botuan në vijim. Gjatë takimit, përfaqësues të pushtetit lokal sollën në vëmendje forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) si koordinatorë të procesit të anëtarësimit dhe pushtetit lokal. Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit mes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe pushtetit lokal i vetmi mendim i sugjeruar dhe pranuar plotësisht nga MEPJ. Sistemi i organizimit, administrimit dhe raportimit mbi konsultimet publike nuk është i përfshirë në strukturën administrative të ministrisë. Masat e ngritjes së kapaciteteve, ristrukturimi organizativ dhe ndarja e personelit duhet të merren në konsideratë për të rritur më tej efikasitetin e procesit të konsultimit publik.

2. Analiza e konsultimeve të kryera

2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Nga 36 akte të planifikuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2020, janë u miratuan vetëm 17 akte.

2.1.2. *Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?*

Nga 17 akte të miratuara u konsultua vetëm një akt Vendimi I Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian”.

2.1.3. *Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse do të kishte të tilla)?*

Aktet e pa konsultuara, janë akte që kanë si objekt miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, çështje që lidhen me sigurinë kombëtare. Referuar parashikimeve të nenit 4 pika b të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.

2.1.4. *Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, rregullore ministrore, etj.)?*

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.151,datë 19.2.2020 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2020–2022.”

2.1.5. *A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?*

Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme në vitet e kaluara ka ndjekur të njëjtën procedurë konsultimi për Planin Kombëtar të Integrimin Evropian. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme njoftoi konsultimin e aktit përmes një takimi publik dhe u dërgoi ftesa personave të interesuar për të marrë pjesë në takimin publik për konsultimin e PKIE.

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. *Cilat ishin metodat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistrin elektronik, postën elektronike, faqet e internetit, takimet publike, komitetet këshilluese, etj.)*

Metoda e përdorur për konsultimin publik të PKIE 2020-2022 ishte nëpërmjet takimit publik me personat e interesuar. Në takim morën pjesë vetëm 9 persona.

Aktiviteti i konsultimit startoi me publikimin online në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të njoftimit për konsultimin e projektvendimit mbi miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022(PKIE 2020-2022) në datë 31.12.2019 <https://punetejashtme.gov.al/sherbime-dhe-mundesinjoftime/>.Nëpërmjet këtij njoftimi,

njoftoheshin të gjithë personat e interesuar të merrnin pjesë në takimin që u mbajt më datë 20.01.2020 për konsultimin publik të PKIE 2020-2022.

Gjithashtu MEPJ njoftoi me postë elektronike të gjitha kontaktet e shoqërisë civile që dispononte (rreth 200 kontakte) për datën e konsultimit publik dhe në këtë komunikim përcolli për dijeni dhe projektvendimin që do konsultohesh.

2.2.2. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda e vetme e përdorur për konsultimin publik të PKIE 2020-2022 ishte nëpërmjet takimit publik. Në këtë takim pati vetëm një mendim mbi forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme si koordinatore e procesit të anëtarësimit dhe pushtetit lokal.

2.2.3. A organizoi ministria gjithashtu disa konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Nuk janë organizuar konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditët e kërkuara? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes?

Për 20 ditët e kërkuara ka qenë planifikuar vetëm një proces konsultimi nëpërmjet takimit publik për konsultim.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Konsultimi publik i Vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian ka patur një kohëzgjatje 20 ditore nga momenti i shpalljes në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në vitet e kaluara është ndjekur e njëjta procedurë për konsultimin publik të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1 *Sa palë interesi të jashtme morën pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve në një vit të caktuar?*

Nuk ka patur palë interesi të jashtme në grupet e punës brenda MEPJ-së për hartimin e PKIE 2020-2022. PKIE është e ndarë në kapitullin “Kriteri Politik” dhe “Kriteri ekonomik” si dhe pjesa planifikuese e PKIE-së, e ndarë në 33 kapituj që i përgjigjen 33 kapitujve negociues. Procesi i planifikimit të PKIE-së kryhet nga institucionet përgjegjëse të kapitujve. Gjatë gjithë procesit të planifikimit MEPJ koordinon punën me GNPIE-të e të 33 kapitujve për hartimin e PKIE-së.

2.4.2 *Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individual, OSHC, kompani, etj.)*

Referojuni pikës 2.4.1.

2.4.3 *Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të bëra për projekt-akte në vitin e caktuar?*

Në takimin e konsultimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian morën pjesë 9 përfaqësues. Vetëm një koment pati nga pushteti lokal.

2.4.4 *Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?*

Në takim morën pjesë 9 subjekte, 8 përfaqësues nga pushteti lokal dhe 1 përfaqësues nga shoqëria civile.

2.4.5 *A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?*

Informacioni mbi konsultimet publike të kryera në vitet e kaluara nuk është i disponueshëm.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. *Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?*

Gjatë takimit publik të mbajtur për konsultimin e PKIE 2020-2022 u dha një rekomandim nga përfaqësuesit e strukturave të integritit të njësisë të qeverisjes vendore.

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Rekomandimi i vetëm i dhënë nga pjesëmarrësit u pranua plotësisht.

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Referojuni pikës 2.4.5.

2.5.4. Cilat janë përfundimet/rezultatet kryesore nga procesi i konsultimit publik për periudhën e fundit

Komenti ishte mbi shkëmbimin e mendimeve mbi forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme si koordinatore e procesit të anëtarësimit dhe pushtetit lokal.

Me miratimin e vendimi të Këshillit të ministrave nr.450, datë 26.7.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësisë të vetëqeverisjes vendor”, dhe krijimin e strukturave të integritit Evropian pranë pushtetit lokal, kontributi i këtyre strukturave në proceset e integritit Evropian dhe PKIE, është një kontribut i nevojshëm për procesin e anëtarësimit në BE.

2.5.5. Ndarja e praktikave më të mira nga procesi i konsultimit publik për periudhën e fundit

Nga MEPJ pati vetëm një akt që ju nënshtroa procesit të konsultimit publik. Gjatë fazës së përgatitjes për takimin e konsultimit publik për PKIE, u njoftuan rreth 200 organizata të shoqërisë civile dhe grupe të tjera të interesi. Vetëm një përfaqësues i një organizate të shoqërisë civile mori pjesë në takim. Pjesëmarrja në një numër të vogël të përfaqësuesve (vetëm 9 përfaqësues) të shoqërisë civile dhe palëve të interesuara rezultoi nga mungesa e përditësimit të listës me personat e kontaktit për palët e interesuara. Nuk ka një listë të kontakteve të palëve të interesuara të publikuara ose të disponueshme. Lista e vetme që MEPJ ka në dispozicion është plotësuar gjatë viteve të kaluara dhe nuk është përditësuar plotësisht.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimesh publikoi ministria?

Ministria për Evropën dhe Punë të Jashtme ka përgatitur një raport për Kryeministrinë mbi procesin e konsultimit publik të PKIE. Ky raport përshkruan fazat e procesit, takimin e këshillimit publik, numrin e pjesëmarrësve në takim dhe komentet e marra në takim.

2.6.2. Nëse disa nuk u botuan, cilat janë arsyet?

Arsyet i referohen kufizimeve në burime njerëzore, shpërndarjen e paqartë të përgjegjësive, përshkrimet e paqarta të punës për pozicionin e personelit dhe paqartësinë / mungesën e procedurës për përgatitjen dhe publikimin e raporteve.

3. Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen *(Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)*

Për të rritur cilësinë dhe transparencën në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve ligjore, është e nevojshme të ngrihen kapacitetet e ministrisë për administrimin e konsultimeve publike. Për këtë qëllim mund të kërkohet asistencë teknike e jashtme. Gjithashtu duhet të konsiderohet dhe ristrukturimi organizativ për një shpërndarje më të mirë të personelit dhe përshkrim pune të qartë.